



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITI OF LIPJAN

## DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Data:	08.05.2026
Për:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës
Kopje:	z.Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	z.Ardian Olluri– Drejtor për Infrastrukturë
Lënda:	<b>Raport për muajin PRILL 01.04.2026-30.04.2026</b>

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturësë gjatë periudhës prej datës 31.04.2026 deri 30.04.2026, DI ka kryer aktivitetet që ka pasur të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara. Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj jave ka pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
28	10	<u>10</u>	3	5

### Aktivitetet gjatë muajit PRILL:

- **Asfaltimi i rrugicave në fshatrat Llugaxhi dhe Dobraj e Madhe**

Kanë vazhduar punimet për rregullimin e rrugicave në Fshatin Dobraj e Madhe, pozicione të cilat është punuar janë: Gërmimi dhe mbushja me material guror i rrugicave në fshatin e lartë cekur, jan kryer rreth 90% e rrugicave me gërmim dhe mbushje.

- **Asfaltimi i rrugicave në fshatrat Bujari, Vershevc, Leletiq, Magure.**

Kontrata është dy vjeçare 2025/2026, kanë vazhduar punimet sipas kontratës, konkretisht është punuar në fshatin Magure dhe Leletiq, ku në fshatin Magure janë përfunduar punimet në pozicionet e gërmimit dhe mbushjes, ndërsa ne Leletiq kemi filluar me punimet në rrugicat e fshatit.

- **Rregullimi i Trotuareve në Fshatin Kraisht**

Gjatë muajit Prill kanë përfunduar punimet në projektin e rregullimit të Trotuarit në Kraisht.

- **Asfaltimi i rrugicave në Fshatrat: Gadime, Sllovi, Babush, Smallush ( Financim i Ministrisë Infrastrukturës)**

OE nuk ka vazhduar me punime për realizim të kësaj kontrate, për arsye së ngritjes së çmimit të derivateve!!

- **Asfaltimi i rrugicave në Fshatrat: Babush, Gadime e Epërme-Kanë** përfunduar punimet në fshatin Babush në pozicionet e germimit dhe mbushjes me material guror.

- **Ndërtimi I Urës rruga Marie Shllaku ( Financim i Ministrisë Infrastrukturës)**

Gjatë muajit Prill kemi filluar me punimet, mirëpo OE vazhdon me intensitet tejet të ulët.

- **Ndërtimi i Qendra Multi funksionale ( Shpija Kulturës )**

Vazhdojnë punimet sipas kontratës së nënshkruar, ku tani jemi duke e përgatitur pllakën mbi përdhes ( armimi dhe betonimi)

- **“Ndërtimi i trotuarve në fshatin Baicë”, me numër identifikues: 613-25-10103-5-2-1.**

Kanë vazhduar punimet duke përfshirë pozicione të ndryshme të kontratës, Germim, Mbushje, Furnizimi dhe montimi i skajorëve.

- **“Ndërtimi i trotuarit Marevc-Llugaxhi” me Nr. Prokurimi 613-25-1267-5-2-1.**

Kontrata ka qenë dyvjeqare, punimet kanë përfunduar vitin e kaluar, këte muaj janë bërë matjet finale si dhe pergaditja e raportin përfundimtar.

- **“Ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndertimit të sheshit, ndertimi i parkut qendror të qytetit dhe parkingut nentokesor në Lipjan” kontrata me nr. 613-23-6745-5-1-1.**

Janë zhvilluar aktivitet përmbyllëse të pozicioneve të mbetura të kontratës.

### **Përgaditja e paramasave dhe parallogarive sipas kërkesave të Drejtorisë:**

Përpilimi i paramasës për Urën në fshatin Gadime.

Punë dhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyshme kohë pas kohe.

Është bërë hartimi I paramasës për ulse në QPS

Vizitë në teren për hartim të paramasës për shkallë të Martirit Uran Amerllahu

Kemi bërë Matje në QKMF për hartim të paramasës.

Është bërë hartimi I paramasës për inventarë në QKMF.

Vizitë teren për montimin e derës dhe dritares te rezervarit në Zonën Ekonomike Qylagë

Janë kryer procedurat për zotimin e mjeteve të projekteve, të cilat disa kanë qënë aktive e disa kanë filluar inicimi i procedurave.

- Takimet me projektusin për projekte .
- Puna me palë
- Punë tjera në zyre .

-